



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

BARAZIA GJINORE NË PRONËN E PALUAJTSHME

**Përgaditur nga:
PHD Kandidate Ariana Qosaj-Mustafa**

Konteksti social/Pengesat për realizimin e të drejtave pronësore

- Pozita socio-ekonomike e grave
- Vendim-marrja brenda familjes
- Përfaqësimi në tregun e punës i grave dhe vajzave
- Përfaqësimi në politikë
- Ushtrimi i të drejtave në trashëgimi de jure dhe de facto
- Sundimi i ligjit dhe korrupsioni (400.000 lëndë të pazgjidhura në gjykatat e Kosovës)
- Mentaliteti patriarkal
- Dhuna në bazë gjinore



Shembuj të disa statistikave relevante

- Në vitin 2014 gratë janë pronare të vetëm 15,2% të pronave, përfshirë edhe pronësinë mbi tokën (gjinia e 10% të pronarëve nuk dihet). Prandaj, pronësia e grave vlerësohet në 8%.
- Ndonëse legjislacioni siguron të drejta të barabarta trashëgimore për vajzat dhe djemtë (fëmijët martesor dhe jashtëmartesor), gratë/vajzat shpesh heqin dorë nga e drejta e tyre në trashëgimi, duke ua dhënë pjesën e tyre të pronës familjare vëllezërve të tyre.
- Në vitin 2011, OJQ Norma raportoi se nga 4,994 rastet e monitoruara në gjykata në pesë rajonet e Kosovës, vetëm në 487 raste (9.75%) gratë dhe burrat kishin trashëguar pronën në mënyrë të barabartë. Gratë nganjëherë e humbin të drejtën në trashëgimi për të vazhduar që të gëzojnë mbrojtjen e vëllezërve ose të familjes së tyre.



..Statistikat/Faktet relevante

- Më tej, anëtarët meshkuj të familjes shpesh nuk japin informata të plota lidhur me numrin e anëtarëve të familjes, duke raportuar në mënyrë të rrejshme anëtarët femra që ekzistojnë. Gjykatat rrallë ose kurrë nuk i verifikojnë këto pretendime ose çertifikatat e vdekjes, të lëshuara nga autoritetet komunale, edhe pse ka raste të çertifikatave të rrejshme të vdekjes.
- Këto vepra penale janë çështje që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit sepse grave u mohohen të drejtat e tyre. Shumica e rasteve për ndarjen e trashëgimisë nuk janë iniciuar ex officio, por nga anëtarët meshkuj të familjes, që është e kundërta e asaj që kërkohet me ligj.






- Një moszhvillim i mjaftueshëm i gjyqësorit, të cilit i mungojnë resurset e mjaftueshme njerëzore dhe buxhetore, korrupsioni, përmbarimi joadekuat i kontratave dhe fakti se mund të bëhen deri në 20 kërkesa për një pronë të vetme (pasi që regjimi serb i ka marrë të gjithë librat zyrtar kadastral në periudhën 1998-1999), të gjitha e pengojnë shpërndarjen e drejtë të pronës.
- Kthimi i kohëve të fundit i kopjeve të librave kadastralë nga Serbia në Kosovë ofron një mundësi të mirë për verifikimin e pronësisë.



- Në të kaluarën, Kanuni i Lekë Dukagjinit ka ndikuar në familjet kosovare, si përmbledhje kryesore e të drejtës zakonore shqiptare.
- Kanuni i përjashtonte gratë nga trashëgimia, duke i njohur vetëm djemtë (bijtë) si trashëgimtarë; rregulla të ngjashme janë aplikuar edhe për bashkëshortet (gratë e martuara).
- Sipas fesë kryesore tradicionale islame, rregulla të tilla nuk aplikohen pasi që vajzat mund të jenë trashëgimtare por jo në menyrë të barabartë me djemtë.



Pjesëmarrja e grave në tregun e punës



Burimi i informatës: D4D, Agon

Maliqi



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave



Gra të moshave 18 deri në 65 vjeç që janë aktive në tregun e punës = ~20%

- Sfidë mbesin numri i lartë i grave dhe vajzave si popullësi joaktive ekonomike



Të drejtat e garantuara sipas konventave ndërkombëtare dhe legjislacionit kyç për barazinë gjinore në Kosovë

- ▶ Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) – tashmë pjesë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe direkt e aplikueshme ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike
- ▶ Ligji për barazi gjinore (2015), (Ligji i parë 2004)
- ▶ Ligjet dhe strategjitë tjera relevante: Ligji për Ndërmjetësim; Ligji për mbrojtje nga diskriminimi; programet e Qeverisë në temën e barazisë gjinore, Ligji i Punës, Ligji mbi Shërbimet Familjare dhe Sociale, Ligji mbi trashëgiminë, Ligji mbi Familjen



Parimet e përgjithshme Ligji për barazinë gjinore

Ky ligj vlen për meshkujt, femrat dhe personat që kanë një karakteristikë të mbrojtur të identitetit gjinor apo të seksit, si dhe garanton mundësi dhe trajtim të barabartë, në sferën publike dhe private të jetës shoqërore, duke përfshirë jetën politike dhe publike, punësimin, arsimin, shëndetësinë, ekonominë, përfitimet shoqërore, sportin, kulturën dhe sferat tjera të përcaktuara me këtë ose ndonjë ligj tjetër.



...

- ✓ Ligji ngre parimin e pjesëmarrjes së barabartë gjinore, perkufizon përfaqësimin e pabarabartë - është atëherë kur pjesëmarrja apo përfaqësimi i njërës gjini, është më i ulët së pesëdhjetë përqind (50%) në çdo organ dhe nivel vendimmarrës në jetën politike dhe publike;
- ✓ Ndalon të gjitha format direkte dhe indirekte të diskriminimit me bazë gjinore



Ndërkohë që barazia gjinore është një çështje e drejtësisë dhe e të drejtave të njeriut, ajo është gjithashtu një parakusht për një rritje të duhur shoqërore dhe ekonomike



Ligji për barazinë gjinore

Masat e përgjithshme për parandalimin e diskriminimit gjinor dhe sigurimin e barazisë gjinore

1. Institucionet publike marrin masa të veçanta të përkohshme me qëllim të përshpejtimit të realizimit të barazisë faktike midis femrave dhe meshkujve në ato fusha ku ekzistojnë pabarazi.
2. Mund të përfshijnë: kuotën; programe për të ndihmuar rritjen e pjesëmarrjes së gjinisë në vendimmarrje dhe jetën publike; Fuqizimin ekonomik si dhe rishpërndarjen e burimeve;



...

Partitë politike Partitë politike me aktet e tyre obligohen të zbatojnë masat për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të meshkujve dhe femrave në organet dhe trupat e partive, në pajtim me dispozitat e nenit 6 të këtij ligji.

Neni 6, pika 8: Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse.



...

Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë në bazë të gjinisë, statusit martesor apo familjar, shtatzënisë, lindjes, prindërisë dhe secilës formë të kujdestarisë në sektorin publik ose privat

Puna e papaguar e femrave dhe meshkujve vlerësohet kontribut për zhvillimin e familjes dhe të shoqërisë, në rast kur ai/ajo: 1.1. kujdeset për mirëqenien e familjes; 1.2. kujdeset për fëmijët; 1.3. kujdeset për anëtarë të tjerë të familjes; 1.4. merret me punët në bujqësi dhe ekonomi familjare.



■ ■ ■

- ▶ Ndalimi i diskriminimit gjinor në qasje dhe furnizim me mallra dhe shërbime
- ▶ Ndalohet diskriminimi mbi bazë gjinore në institucione arsimore në të gjitha nivelet, duke përfshirë qasjen në arsimim, procesin e pranimit, qasjen në shërbime, mjete dhe përfitime si bursat, rezultatet e vlerësimit, marrjen e diplomave dhe titujve shkencor, qasjen në trajnime profesionale, ndjekjen e arsimimit, sporteve dhe fushave tjera
- ▶ Gjobat e ulëta prej 300 deri ne 900 Euro.



...

Statistikat gjinore

Ligji për barazinë gjinore poashtu parasheh se institucionet e Kosovës duhet të mbledhin, verifikojnë procesin dhe analizojnë statistikatat, dhe duhet të përfshijnë indikatorin gjinor në të gjithë aktivitetet e tyre, regjistrimin e popullsisë, hulumtimet demografike apo çdo kërkim të ndonjë lloji tjetër.

Ndarjen sipas gjinisë të të gjitha të dhënave të nevojshme statistikore, që mblidhen, regjistrohen, përpunohen dhe obligohen që këto të dhëna t'i dorëzojnë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës



Ligji për barazinë gjinore

Mekanizma të ngritura në nivelin **qendror**

- Komisioni Parlamentar për të drejta te njeriut;
- Zyra e Ombudspersonit (Avokati popullit);
- Agjencia për Barazi Gjinore
- Zyra për Qeverisje të mirë në Zyrën e Kryeministrit

Ligji për barazinë gjinore

Mekanizma të ngritura në nivelin **qendror**

- Njësitet për të drejtat e njeriut në çdo ministri
- Zyrtaret/ët për Barazi Gjinore ne çdo Ministri
- Grupi ndërministror për barazi gjinore
- Agjencia e Statistikave të Kosovës

Ligji për barazinë gjinore

Mekanizma të ngritura në nivelin lokal

- Njësitë për të drejtat e njeriut në kuadër të komunës;
- Zyrtaret/ët për Barazi gjinore në komunat e Kosovës

Ligjet dhe procedurat relevante për zbatim të menjëhershëm

UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. 03/2016 PËR MASAT E VEÇANTA PËR REGJISTRIMIN E PRONËS SË PALUJTSHME TË PËRBASHKËT NË EMËR TË DY BASHKËSHORTËVE

Parashihet si masë e veçantë për të përshpejtuar barazinë gjinore – si masë e përkohshme, të cilat kanë për qëllim garantimin e të drejtave të barabarta gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore në fushat specifike të jetës shoqërore;

Pronë e përbashkët e bashkëshortëve – nënkupton pasurinë e krijuar gjatë jetës në martesë e cila regjistrohet si pronë e përbashkët, administrohet bashkarisht dhe nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e bashkëshortëve

Ky udhëzim administrativ zbatohet për periudhën një (1) vjeçare nga dita e hyrjes në fuqi. **04 mars 2016**



...Përkufizimet sipas UA NR. 03/2016

Tarifa – nënkupton shumën e pagesës për shërbimet për regjistrimin e të drejtës së pronësisë/posedimit;

Noteri – nënkupton juristin profesional, zyrtar publik i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për ta ushtruar veprimtarinë e përcaktuar me ligj.

Tatimi në pronë – nënkupton taksën vjetore komunale.

Posedimi - nënkupton shfrytëzimin e përhershëm të pronave të palujtshme



...Të drejtat kyçe sipas UA NR. 03/2016

- Kontrata për blerjen e një pasurie të paluajtshme dhe dokumentet tjera për fitimin e drejtës së pronësisë dhe posedimit që është krijuar me kontributin e të dy bashkëshortëve duhet të përmbajë emrat e të dy bashkëshortëve si bartës të së drejtës së pronësisë së përbashkët në pjesë të pa përcaktuara;
- Në rastet kur prona e paluajtshme është e regjistruar në emër të vetëm njërit bashkëshort ajo nuk mund të shitet apo të tjetërsohet në çfarëdo forme tjetër pa pëlqimin me shkrim të bashkëshortit tjetër, të vërtetuar nga organi kompetent.



...Lehtësimet e ofruara

- Nëse bashkëshortët e regjistrojnë pronësinë dhe posedimin sipas nenit 5 të këtij Udhëzimi Administrativ do të lirohen nga tarifa e regjistrimit e paraparë me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr 08/2014 për Tarifat e Shërbimeve për regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme nga zyrat kadastrale komunale



Organet përgjegjëse

- 1.1. Zyrrat komunale përkatëse kadastrale;
- 1.2. Zyrrat e gjendjes civile;
- 1.3. Drejtoria komunale përkatëse për tatim në pronë;
- 1.4. Noteria;
- 1.5. Organet dhe institucionet tjera që merren me regjistrim të drejtave pronësore.



- Faleminderit për vëmendje
- Ndarja e diskutimit lidhur me iniciativat avokuese në teren lidhur me promovimin e të drejtës së grave në pronë
- Gjetja e modaliteteve për shpërndarjen e informacionit
- Ko-ordinimi

